

**Deklaratë e Achilleas PAPPAS**

TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR NDJEKJEN PENALE TË PERSONAVE  
PËRGJEGJËS PËR SHKELJE TË RËNDA TË SË DREJTËS HUMANITARE  
NDËRKOMBËTARE TË KRYERA NË TERRITORIN E ISH-JUGOSLLAVISË PREJ  
VITIT 1991

**TË DHËNA MBI DËSHMITARIN:**

Mbiemri: PAPPAS

Emri: Achilleas

Nofka: nuk ka

Emri i babait: Chrisostomos Emri i nënës: Theodora

Datëlindja: 11.12.1968 Gjinia: Mashkull

Vendlindja: Janinë, Greqi

Origjina etnike: grek Përkatësia fetare: ortodoks grek

Profesioni i tashëm: Kapiten në Forcën Ajrore Greke

Gjuhë të folura: greqisht, anglisht, frëngjisht

Gjuhë të shkruara: greqisht, anglisht, frëngjisht

Data-t e intervistës/-ave: E premte më 4 maj 2007, e diel më 6 maj 2007, e hënë me 7 maj 2007

Vendet e intervistës: Zyra e Prokurores, Dhoma 483 (e premte më 4 maj, e hënë më 7 maj 2007), Dhoma 326 (e diel më 6 maj 2007), Dhoma 425 (e martë më 8 maj 2007)

Intervistues: Gramsci Di Fazio

Përkthyes: nuk ka pasur

Gjuhë të përdorura në intervistë: anglisht

Emrat e të gjithë personave të pranishëm gjatë intervistave: Gramsci Di Fazio, Thomas Obruca, William Byrne të premtën më 4 maj 2007 dhe Gramsci Di Fazio, Shahzada Sultan të dielën, të hënë dhe të martën më 6, 7 dhe 8 maj 2007)

Nënshkruar / Inicialet: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/

## Deklaratë e Achilleas PAPPAS

1. I jap këtë deklaratë Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ). Nuk jam kërcënuar as jam detyruar të vij këtu, as më janë bërë kurrfarë premtimesh apo nxitjesh për të vepruar kështu.
  2. Jam pajtuar të jap një deklaratë me shkrim të nënshkruar.
  3. Kam lindur në qytetin e Janinës, në Veriperëndim të Greqisë në vitin 1968. Pas diplomimit në Leceum i jam bashkuar Akademisë së Forcës Ajrore më 1989, ku kam diplomuar në vitin 1993 me rangun Lejtnant i 2-të. E kam marrë pozicionin e meteorologut dhe kam punuar në qendrën nacionale meteorologjike në Athinë deri në janar të vitit 1998.
  4. Në fund të janarit të vitit 1998 e fillova dislokimin tim me ECMM (European Commission Monitoring Mission – Misioni Monitorues i Komisionit Evropian) në Bosnjë & Hercegovinë. Jam caktuar së pari në Visoko, që është një qytet mu jashtë Sarajevës. Pas rreth 2 muajsh jam bërë lider i ekipit për Ekipin e Visokos. Detyrat kryesore të dislokimit tonë kanë qenë monitorimi dhe takimi i autoriteteve vendore dhe raportimi rreth një numri çështjesh si çështjet politike, ekonomike, të refugjatëve, të individëve të zhvendosur, çështjet religjioze dhe çështjet ushtarake.
  5. Kjo përfshinte një larmi të gjerë detyrash. Për shembull, ne studionim mbulesën e ngjarjeve nga media në rajon, do të takonim njerëzit vendorë e ndonjëherë perfaqësuesit e tyre për të parë nëse kishin ndonjë problem, vizitonim rajonet ku ishin të përqendruar refugjatët dhe përpiqeshim të kuptonim për problemet e tyre specifike për ata refugjatë dhe raportonim për standardin e kujdesit mjekësor. Ne po ashtu monitoronim përdorimin e fondeve nga ana e organizatave humanitare dhe veçanërisht monitoronim përdorimin e fondeve nga Bashkimi Evropian. Do të merrnim njoftim nga shtabi ynë në Bruksel për t'u përqendruar mbi disa çështje në kohë të caktuara. Gjatë kësaj kohe jam caktuar për rreth 1 muaj në Shtabin e ECMM-së në Sarajevë, ku kam qenë përgjegjës për “Desk-un A”, që merrej me çështje humanitare dhe ekonomike për Shqipërinë, Serbinë & Malin e Zi dhe IRJM-në.
  6. Për shkak të zhvillimit politik në Kosovë jam dislokuar në Ekipin e ECMM-së në Pejë rreth datës 16 apo 17 korrik 1998. Mund ta them këtë duke iu referuar një shënimi në pasaportën time diplomatike të cilën e kam marrë më 15 korrik 1998 (bashkëngjitur me këtë dokument, dhe shënuar si Aneksi A, është ekstrakti që e tregon këtë datë). Formalisht jemi vendosur nën autoritetin e Ambasadave tona; mirëpo, ne ende punonim për Bashkimin Evropian. I jam bashkuar Ekipit Peja I në mes të korrikut 1998. Në këtë pikë kohore ekipi përbëhej vetëm prej monitoruesve ndërkombëtarë, gjegjësisht Wolfgang Kaufmann, një oficer i pensionuar i Forcës Ajrore Gjermane, i cili ishte Lider ekipi, dhe unë. Me fjalë të tjera, Kaufmann-i dhe unë përbënim ekipin Peja I. Stacioni ynë gjendej në Pejë ne Hotelin Dypon që ishte afër një stacioni hekurudhor jashtë përdorimit. Përveç kësaj kishte edhe përkthyes në ekipin tonë, gjegjësisht një shqiptar me emrin Kastriot, dhe një përkthyes serbe me emrin Jovana Bojiq (Bojić). Kaufmann ishte përgjegjës për përzgjedhjen e këtyre përkthyesve.
  7. Detyrat tona kryesore ishin në radhë të parë për të monitoruar situatën në rajon lidhur me lëvizjet e trupave serbe dhe zhvillimin e përgjithshëm të konfliktit, për t'u takuar
- Nënshkruar / Inicialt: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/

## Deklaratë e Achilleas PAPPAS

me përfaqësuesit vendorë të rajonit, si me politikanë, prefektë, liderë të partive dhe liderë fetarë si dhe me civilë, si të etnisë serbe ashtu dhe asaj shqiptare. Për të marrë informacion rreth UÇK-së dhe aktiviteteve të tyre, për shembull, kemi biseduar me këdo që kemi qenë në gjendje ta identifikonim si anëtar të UÇK-së, si dhe me popullatën në fshatra të ndryshme. Në fillim të periudhës sime kohore në Kosovë, nuk ka pasur prani të dukshme të UÇK-së. Gjatë aktiviteteve tona të udhëtimit dhe të monitorimit, shpesh kemi parë shqiptarë të armatosur në rroba civile dhe i kemi pyetur nëse ishin anëtarë të UÇK-së, por ata vetëm thoshin se ishin të armatosur dhe se po mbroheshin kundër serbëve. Po përpiqeshim të themelonim kontakt me UÇK-në me qëllim që të kuptonim për strukturën dhe operacionet e UÇK-së. Për ta bërë këtë, do të ndalonim nëpër fshatra dhe do të flisnim me shqiptarët vendorë dhe do të bënim pyetje rreth UÇK-së, mirëpo nuk ishin të gatshëm të jepnin informacion dhe ndonjëherë do të identifikonin ndonjë individ të veçantë në një mënyrë të rastësishme se ishte anëtar i UÇK-së. Kurrë nuk kemi qenë të sigurtë nëse kjo ishte e saktë ose jo. Nuk ishim në gjendje të themelonim kontakte me komandantët ushtarakë serbë as kemi pasur qasje në rajonet ushtarake serbe, dhe gjatë gjithë kohës sime atje, kurrë nuk kam qenë në gjendje të takohem me personelin ushtarak, me gjithë përpjekjet e përsëritura të Kaufmann-it për të kontaktuar dhe për të takuar komandantë të tillë ushtarakë serbë.

8. Gjithashtu duke punuar krahas ekipit tonë ishte Ekipi Peja II që përbëhej nga dy monitorë ndërkombëtarë: Lars Larsen nga Danimarka dhe një kolegë frëng emri i të cilit nuk më kujtohet. Që të dyja ekipet e ndanin rajonin e përgjegjësisë ashtu që Ekipi Peja II ishte përgjegjës për rajonin në veri të Pejës, kurse Ekipi Peja I (ekipi im) e mbulonte rajonin në drejtim të jugut. Këto ndarje janë vendosur me ekipet dhe ishin ndarje informale. I gjithë rajoni i përgjegjësisë së Ekipit Peja I&II ishte si më poshtë: kufiri jugor ishte pika më jugore e komunës së Gjakovës, kufiri verior ishte me Malin e Zi, kufiri perëndimor ishte me Shqipërinë. Në lindje ishte komuna e Klinës. Për patrullat tona përdornim një Land Rover të blinduar me shkronja të mëdha që tregonin statusin tonë si monitorë si në shqip ashtu dhe në serbisht. Land Rover-i që e përdorte Ekipi I ishte një makinë e ECOMM-së nga Bosnja, por me të arritur në Serbi, është bërë makinë diplomatike e ngjitur për Ambasadën greke. E njëjta ka ndodhur me automjetin tjetër që kemi përdorur, por nuk më kujtohet se cilit shtet i është ngjitur automjeti tjetër. Automjeti që kam përdorur mbante një flamur të vogël grek, si dhe një 'stiker' të madh të Bashkimit Evropian.
9. Kur arrita në Kosovë rreth 16 apo 17 korrikut 1998, kishte shumë përplasje midis serbëve dhe UÇK-së, por vetëm në rajone rurale. Në qytetet kryesore (si Peja dhe Gjakova) situata ishte mjaft e qetë, përveç gjatë natës kur mund të dëgjoje të shtëna sporadike dhe detonime të granatave të dorës. Gjetëm shumë fshatra të braktisura apo grupe shtëpish, të cilat ishin plaçkitur dhe shumica prej tyre po ashtu ishin djegur. Do ta përshkruaja situatën si më poshtë: serbët kontrollin të gjitha qytetet kryesore dhe rrugët kryesore që ndërlidhnin këto qytete, duke përfshirë Pejën, Deçanin, Gjakovën, Klinën dhe Mitrovicën. Puna ime kërkonte që unë të udhëtoja prej Pejës përgjatë rrugës për Gjakovë. Ndonjëherë udhëtoja deri në Gjakovë, por më shpesh kam udhëtuar deri përtej Deçanit përgjatë rrugës në rajon përafërsisht deri në mes të rrugës midis Deçanit dhe Gjakovës. Kishte postblloqe serbe përafërsisht në intervale prej pesë kilometrash. Serbët shpesh na e tërhiqnin vërejtjen që të mos udhëtonim më tej dhe na informonin se nuk mund të na e garantonin sigurinë. Kurrë nuk jemi ndaluar nga

Nënshkruar / Inicialet: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/

## Deklaratë e Achilleas PAPPAS

postbloquent e UÇK-së në këtë rrugën kryesore. Kemi parë automjete të ushtrisë dhe policisë serbe që e përdornin këtë rrugë kohë pas kohe. E njëjta situatë vlente për rrugën kryesore Pejë – Prishtinë në të cilën po ashtu udhëtonim sa u përket postbloqeve serbe dhe trafikut serb. Nuk kam udhëtuar për Klinë por nuk mund të komentoj nëse kolegët e mi prej Ekipit Peja I apo Ekipit Peja II kanë udhëtuar ose jo.

10. Ne po ashtu kemi udhëtuar larg rrugëve kryesore me qëllim që të flisnim me fshatarë dhe përpqeshim të vënim kontakt me UÇK-në. Pothuaj çdo ditë kemi vozitur në rrugën kryesore Pejë – Gjakovë dhe kemi vizituar fshatra shqiptare që gjendeshin si në lindje ashtu dhe në perëndim të rrugës kryesore. Kjo vazhdoi midis kohës së arritjes sime dhe datës 11 gusht 1998 kur jam rrëmbyer bashkë me kolegët e mi. Vendet që kemi vizituar përfshinin Irzniq, Ratishë e Poshtme, Baballoq, Lumbardh, Gllgjan, Deçan, Kryshec, Junik, Lloqan dhe rajonin rural në perëndim të Deçanit ku gjendet manastiri. Kurrë nuk kemi hasur në postbloqe serbe sapo largoheshim nga rruga kryesore Pejë – Gjakovë. Ishte befasuese për mua të shihja se sa shpejt hasnim në postbloqe të UÇK-së pasi që largoheshim nga rruga kryesore. Shpesh brenda 50 deri 100 metra. Postbloquent e tilla shpesh gjendeshin në kryqëzime. I dalloja këto postbloqe si postbloqe të UÇK-së sepse disa nga njerëzit që rrinin aty kishin uniforma ushtarake dhe kishin shenja të UÇK-së.
  11. Kur arrita së pari dhe fillova të punoja në rajon, udhëtonim në drejtim të jugut nga Peja në rrugën kryesore Pejë – Gjakovë. Kemi udhëtuar në brendi por nuk kemi hasur postbloqe të UÇK-së. Ky rajon, ndërkaq, ishte në rajonin në jug të Pejës, por para Deçanit diku nga mesi i rrugës. Ndonjëherë kemi hasur postbloqe ku kishte të rinj, dhe kur i pyesnim nëse ishin UÇK apo nëse dinin se ku ishte UÇK-ja, ata nuk na jepnin informacion konkret. Ata nuk kishin uniforma të UÇK-së. E njëjta vlen për rrugën kryesore Pejë – Prishtinë. Me fjalë të tjera, kur largoheshim nga rruga kryesore, kishte mungesë të postbloqeve të UÇK-së, mirëpo, kur shkoje më tej në drejtim të jugut përtej Deçanit në rrugën Pejë – Gjakovë, dhe sidomos në lindje të asaj rruge, postbloquent e UÇK-së mund të gjendeshin.
  12. Shqiptarët prandaj operonin në rajone rurale, larg rrugëve kryesore. UÇK-ja okuponte rajone të mëdha dhe fshatra, por nuk i lejonte popullatës vendore të largohej nga rajone dhe fshatra. Kam folur disa herë me fshatarë duke i pyetur pse nuk po largoheshin nga këto vende. Përgjigjet e tyre ishin gjithmonë të njëjtat, gjegjësisht se nuk lejoheshin nga UÇK-ja, përndryshe do të vriteshin. Granatimi dhe të shtënat ndodhnin sporadikisht, por jo për çdo ditë. Serbët operonin me qëllim që ta mbanin UÇK-në larg rrugëve kryesore dhe nga qytetet kryesore, por në anën tjetër, ata nuk përpqeshin të futeshin dhe të okuponin fshatra në rajone rurale. E dija këtë nga ajo që më kishin thënë fshatarët dhe kisha dëgjuar nga fshatrat se serbët përdornin altoparlantë dhe fletushka (edhe pse kurrë nuk kam parë ndonjë fletushkë) për t'i inkurajuar fshatarët që të largoheshin nga fshatrat e tyre. Ata i informonin fshatarët për rrugët e ikjes, për shembull në veri të fshatit. Kam dëgjuar për këtë lloj të taktikës serbe katër apo pesë herë në muajin e parë që kam qenë atje. Mbresa ime e kësaj taktike serbe është se ishte dizajnuar për të futur frikë te popullata vendore shqiptare, por jo për t'i marrë fshatrat.
  13. Gjatë kohës sime atje, popullata shqiptare i konsideronte ata të UÇK-së se ishin heronj. Për këtë informoheshim gjatë vizitave tona nëpër fshatra. Gjatë vizitave tona në
- Nënshkruar / Inicialet: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/

## Deklaratë e Achilleas PAPPAS

fshatrat shqiptare, na ftonin nëpër shtëpi dhe do ta diskutonim situatën lokale. Ata do të na informonin se UÇK-ja po luftonte për ata, por kur i pyetnim se çka do të ndodhte nëse nuk e mbështetnin UÇK-në ata na thoshin se mund të kishin problem. Ne kurrë nuk kemi dëgjuar sentimente të tilla kur bisedonim me ndonjë turmë në fshat, por kemi dëgjuar sentimente të tilla në shtëpi private. Ne vazhdimisht pyetnim për identitetin e liderëve të UÇK-së apo të komandantëve, por nuk na jepej informacion.

14. Gjatë kohës sa kam qenë në Kosovë, kam dëgjuar për vrasje nga secila palë në konflikt. Serbët dhe shqiptarët akuzonin njeri-tjetrin se po u vritnin njerëzit e tyre. Më kujtohet një incident në fillim të gushtit 1998 kur e pashë kufomën e një burri shqiptar shtrirë pranë rrugës, në hyrje të një fshati. Nuk më kujtohet emri i fshatit, por më kujtohet se ishte në jug të rrugës Pejë – Prishtinë dhe se kishte fshatra të çuditshme krejt të braktisura. Kufoma ishte gjetur gjatë patrullimit tonë të rajonit dhe tashme ishte shpërbërë dhe ishte gjymtuar nga shtazët. Vetë fshati ishte braktisur dhe dukej se fshatarët si dhe UÇK-ja ishin tërhequr prej andej (edhe pse më duhet të theksoj se ky ishte një rajon ku nuk kishim parë ushtarë të UÇK-së të armatosur në uniforma me shenja të UÇK-së, duke mbajtur postbloquent). Po atë ditë, më kujtohet se kemi vozitur nëpër një rrugë të vogël në drejtim të një fshati (po ashtu në të njëjtin rajon ku u gjet kufoma) dhe papritmas pamë një tank serb në rrugë me grykën e topit të drejtuar prej nesh. U afruam ngadalë dhe na u dha leja për të vazhduar për në fshat dhe në fshat pamë ushtarë serbë duke plaçkitur shtëpi dhe duke i djegur. Për habi, ata nuk u duken të shqetësuar që ne ishim aty. Kjo ishte hera e parë dhe e vetmja që pashë forca serbe larg rrugëve kryesore gjatë kohës sime në këtë post.
15. Kur arrita në zonën e Dukagjinit, nuk kam ditur për ndonjë strukturë apo komandë të UÇK-së. Në fakt, kjo ishte njëra nga gjërat kryesore që donim ta kuptonim dhe nuk ishim informuar për grupet që operonin në rajon. Ne vetëm vumë re disa grupe të vogla të UÇK-së nëpër fshatra gjatë patrullimeve tona, por kurrë nuk ka pasur më shumë se 50 anëtarë të UÇK-së në një vend së bashku. Kjo ndodhte kur largoheshim nga rruga kryesore Pejë – Gjakovë, në jug të Deçanit dhe kur udhëtonim në brendi në drejtim të lindjes. Do të shihnim rreth pesë njerëz të UÇK-së në një postbloquent, por asnjëherë më shumë se kaq. Mirëpo, kur hynim në fshatra, shpesh shihnim njerëz të armatosur disa prej të cilëve ishin në uniforma të UÇK-së dhe ata do të mblidheshin për të folur me ne. Po e theksoj, ndërkaq, se kjo ndodhte në situata të qeta, ku çoheshin jetë normale fshatareske.
16. Hera e parë që kam dëgjuar diçka për organizimin dhe strukturën e UÇK-së ishte në mes të gushtit të vitit 1998, pasi që Ekipi ynë u kidnapua nga anëtarë të UÇK-së dhe të cilës do t'i referohem më vonë më në detaje. Ishte diku afër fshatit Bërliq kur iu prezantua një shqiptari rreth moshës 50 vjeçe, i cili ishte gjeneral i UÇK-së. Ai na tha se ishte anëtar i APJ-së për 20 vite. Ai tha se ishte komandant i rreth 70% të UÇK-së dhe se ai ishte një prej disa komandantëve në Kosovë. Gjatë këtij diskutimi, ai gjithashtu përmendi se kishte vetëm një person që ishte në gjendje të jepte një komandë të përgjithshme apo t'i thërriste të gjithë ata dhe se nofka e tij ishte Komandant "Çeliku". U përpoqëm të nxirnim më shumë prej tij në këtë pikëpamje, edhe pse nuk dha më shumë detaje. Unë nuk e njihja këtë komandant në këtë kohë me emër; ai na është prezantuar vetëm me nofken e tij si "Toni". Më kujtohet se gjatë kësaj bisede ai po ashtu na tregoi se kishte disa grupe ekstremiste brenda UÇK-së në rajon të cilat

Nënshkruar / Inicialet: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/

**Deklaratë e Achilleas PAPPAS**

ishin jashtë kontrollit. Ai tha se ata ishin të nevojshëm tani për të bërë luftën, por pasi që të mbaronte lufta, ata do të duhej të vriteshin me qëllim që të ndaleshin që të mos vazhdonin të luftonin.

17. Më kanë treguar një raport nga ECMM-së Ekipi Peja I&II të datës 11 gusht 1998 që mba numrin R025-5254-R025-5256 dhe mund të konfirmoj se ky është raport ditor i ekipit tonë që e përmend rrëmbimin tonë. Raporti është përpiluar nga lideri i Ekipit tonë Kaufmann-i. Unë gjithashtu kam përpiluar një raport personal për Ambasadat greke në Beograd dhe Sarajevë rreth këtij incidenti, që ka qenë më i detajuar se ky raport ditor.
18. Mora përshtyjen time të parë rreth involvimit të vërtetë të UÇK-së në vrasje kur kam dëgjuar për gjetjen e një varreze masive në rajonin e Ratishës së Poshtme afër kanalit prej betoni. Kurrë nuk isha qenë te Liqeni i Redeniqit më parë. Gillogjani ishte pika më e afërt e liqenit që kisha qenë. Ishte më 17 shtator 1998 kur e vizitova gjyqin në Pejë dhe e takova kryetarin e gjyqit, Zotin Zhivojin Cvejiq (Živojin Cvejić) dhe prokurorin Rade Gojković (Gojković) ( e mora datën e vizitës duke iu referuar një raporti tjetër që e kam bërë për ambasadën time greke më 5 tetor që është data që e kam shkruar raportin). Ata ishin shumë miqësorë dhe pas një bisede të shkurtër ata e përmendën varrezën masive të gjetur afër fshatit të Ratishës së Poshtme, që është vetëm 1.5 km larg fshatit Gillogjan. Kjo varrezë masive është zbuluar nga policia serbe disa ditë pas sulmit të suksesshëm të forcave serbe dhe UÇK-ja është zbrapsur nga ky territor. Kështu kam shkruar me një përkthyes serbe, Jovana BOJIQ, për t'u takuar me prokurorët për të folur për çështjet si të burgosurit dhe keqtrajtimin e shqiptarëve dhe kanë qenë prokurorët që e ngritën çështjen e kufomave te Liqeni. Prokurorët na ftuan ta vizitonim rajonin ku këto kufoma ishin gjetur, si dhe morgun në Gjakovë të nesërmen. Më duhej të flisja me Kaufmann-in së pari para se të merrej ndonjë vendim për një vizitë të tillë. Morgu ishte instaluar në bodrumin e një hoteli që gjendej në qendër të qytetit. E vizitova vendin e krimit dhe morgun të nesërmen më 18 shtator 1998.
19. Të nesërmen e kam vizituar morgun bashkë me Kaufmann-in. Së pari kemi shkruar te morgu e pastaj më vonë të vendi i ngjarjes te Liqeni i Redeniqit. Në morg, pamë mbetjet e 24 kufomave, mirëpo na thanë se në rajonin përreth vendit të varrezës masive kanë gjetur pjesë të tjera të trupave njerëzore, si duar e këmbë, që çonte në përfundimin se kishte pasur më shumë viktime sesa këto 24 në morg. I jemi prezantuar një patologu me emrin Branimir Aleksandriq (Aleksandrić). Shkaqet e vdekjes së atyre njerëzve ishin klasifikuar në tri kategori, sipas Aleksandriqit. E para ishte ekzekutimi me mitralozë; e dyta ishte ngulfatja me litarë, kablo dhe tel me gjemba, e treta ishte nga rënia prej lartësisë së madhe. Ai na informoi se shumica e viktimave ishin torturuar para se të vdisnin. Kjo është themeluar me faktin se ata kanë gjetur litarë, tel me gjemba dhe kablo rreth qafëve dhe trupave të pothuaj të gjitha viktimave. Për demonstrim ai na tregoi një pjesë skalpi ku ende mund të shihje telin me gjemba ngjitur për flokë. Ky demonstrim u bë në morg. Po ashtu në morg patologu na tregoi një video shirit të ekipit që po i merrte kufomat. Kjo shihet se ishte incizuar gjatë nxjerrjes së kufomave. Ishte një ekip që përbëhej nga doktorë dhe infermierë që ishin shoqëruar

Nënshkruar / Inicialet: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/

## Deklaratë e Achilleas PAPPAS

nga oficerë të policisë serbe. Pamë vetëm një pjesë të shkurtër pasi që Kaufmann-i tha se nuk kishim shumë kohë. Video na është treguar sipër në hotelin ku gjendej morgu.

20. Ne pastaj të gjithë vozitëm për te Liqeni. Kaufmann-i, përkthyesja serbe, Jovana Bojiq, dhe unë shkuaam te Liqeni në automjetin tonë, dhe ishte një ekip policësh në një automjet të blinduar që na shoqëronin. Aleksandriqi qendroj në morg dhe mendoj por nuk jam i sigurt, se Gojkoviqi po ashtu erdhi me ne. Cvejiqi erdhi me ne.
21. Në pjesën ku ishin gjetur kufomat, ishte një kanal i vogël rreth tri metra i thellë, që përfundonte në këtë pikë në një kanal të natyrshëm apo përrua, që ishte rreth 25 metra më i thellë. Dukej si një ujëvarë e vogël. Ky përrua përfundon në Liqenin e Redeniqit. Në muret e kanalit njeriu mund të shihte qartë shenjat e plumbave, që ishte e qartë se i kishin vrarë këta njerëz. E them këtë për shkak të gjykimit të shëndoshë dhe nga ajo që na u tha por natyrisht se unë nuk kam bërë ndonjë ekzaminim mjekoligjor. Patologu na informoi se gjatë ditëve të para të nxjerrjes së kufomave në këtë vend ata kishin gjetur 19 kufoma përpara murit jashtë kanalit. Ai po ashtu na informoi se disa prej tyre ishin varrosur dhe pjesa tjetër ishin shtrirë në sipërfaqe, dhe se pesë kufoma të tjera janë gjetur në përroit e natyrshëm. Ai na informoi se për shkak të motit gjatë ditëve të para të nxjerrjes së kufomave, shiut të madh, ata nuk kishin mundur ta gjurmonin të gjithë vendin përreth më poshtë përroit. Më tej patologu vlerësoi se koha e vrasjes së këtyre viktimave ishte një deri në një muaj e gjysmë më parë. Kjo bazohej në nivelin e kalbjes së kufomave.
22. Kur po e vizitoja vendin e varrezës masive për herën e parë, që ishte më 18 shtator 1998, unë nuk kam qenë personalisht dëshmitar i ndonjë nxjerrjeje kufomash. Të gjitha mbetjet e viktimave që kam parë ishin në morg në Gjakovë. Kur isha në morg numërova 24 thasë kufomash që përmbanin mbetjet e viktimave. Këtë detal e mora nga raporti që shkrova më 5 tetor 1998. Pashë një kafkë dhe disa mbetje të tjera të boshtit kurrizor. Kufomat e kalbura që qeshë në gjendje t'i shihja ishin në një fazë të shtyer të kalbjes, që më tregonte qartë faktin se ato kishin qenë të shtrira aty në vend për një periudhë më të gjatë kohore. E pashë këtë nga mendja e shëndoshë, por natyrisht unë nuk jam ekspert i mjeksisë ligjore mbi dukjen e kufomave të kalbura as që mund të komentoj me ndonjë autoritet se sa gjatë një kufomë është kalbur. Më tej jam informuar se viktimat ishin të etnisë serbe dhe shqiptare, të të dy gjinive. Në bazë të informacionit që morëm nga doktorët kjo ishte konstatuar përmes mbetjeve të rrobave dhe përmes informacionit të marrë nga të afërmit e personave të zhdukur. Disa ditë më vonë, rreth 26 shtatorit 1998, lexuam në një gazetë shqipe se numri i gjithmbarshëm i kufomave të nxjerra ishte tridhjetë e gjashtë. Ky informacion erdhi nga Kastrioti që i lexonte gazetën shqipe. Tridhjetë (30) prej tyre ishin shqiptarë kurse gjashtë ishin serbë që të gjithë të identifikuar sipas informacionit të marrë nga Kastrioti prej gazetave. E bëj absolutisht të qartë se unë nuk e kam parë asnjë kufomë të vetme apo mbetje njerëzore gjatë vizitës sime te Liqeni i Redeniqit dhe pjesës së kanalit.
23. Nuk kishte dyshim se varreza masive ishte e ndërlidhur drejtpërsëdrejti me praninë e UÇK-së në rajon. E theksoj, ndërkaq, se ky është mendimi im dhe mendimi i Ekipit Peja I. Mendimi im bazohet në këto konsiderime. Varreza masive gjendej në një rajon që kontrollohej nga UÇK-ja derisa i është dashur të tërhiqej për shkak të sulmit serb në fund të gushtit dhe fillim të shtatorit 1998. Në bazë të nivelit të kalbjes së kufomave,
- Nënshkruar / Inicialet: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/

## Deklaratë e Achilleas PAPPAS

ishite e qartë se ata ishin vrarë një kohë para se të ishin gjetur, që ishte indikacion se vrasja kishte ndodhur gjatë kohës UÇK-ja e kontrollonte këtë rajon. Nuk ka pasur asnjë prani serbe në këtë rajon deri me sulmin serb. Rajoni i kontrolluar nga UÇK-ja fillonte në lindje të rrugës kryesore Pejë – Gjakovë. Kam thënë më parë se rruga kryesore kontrollohej nga serbët, mirëpo disa metra më larg në drejtim të lindjes fillonte rajoni i dominuar nga UÇK-ja. Shkonte larg përtej Liqenit të Redeniqit. Në fakt rajoni i kontrolluar nga UÇK-ja deri në këtë kohë kufizohej nga rrugët kryesore. Së pari nga rruga kryesore që e lidh Pejën me Gjakovën, së dyti nga rruga kryesore që e lidh Pejën me Prishtinën. Çdo gjë brenda saj ishte rajon i mbajtur nga UÇK-ja. E njëjta situatë ka mbetur pas ofensivës serbe në vitin 1998, kur Shtabi në Glllogjan është shkatërruar. I vetmi ndryshim është se territori i tyre është shtyrë mbrapa nga rruga Pejë – Gjakovë. Madje edhe kur kemi shkuar te Liqeni i Redeniqit na është dashur përcjellje e madhe e policisë.

24. Pas zbulimit të vendit të varrezës masive policia serbe filloi të eksploronte rajonin përreth. Më ka informuar për këtë Cvejiqi. Në një largësi prej rreth 500 metrash ata kanë gjetur një shtallë të zbrazët të përdorur për gjënë e gjallë. Dukej se kishte qenë pjesë e një ferme dhe kishte pasur disa ndërtesa të tjera më të vogla në afërsi. Brenda kësaj shtalle ata kanë gjetur evidencë që tregon se individët janë paraburgosur aty, janë lidhur me kablllo dhe shufra hekuri që ishin pjesë e vathit. E vizitova vendin bashkë me Kaufmann-in dhe përcjelljen e policisë. Personalisht kam mundur t'i shihja kabllot që kishin mbetur, të cilat ende ishin të varura në shufrat e hekurit. Më kujtohet se njëra prej kablllove kishte pasur flokë në të, që m'u duk mua se ishin flokë njeriu. Kjo nuk më është treguar nga ndonjëri prej serbëve që më shoqëronin, unë e pashë pavarësisht. Më kujtohet se po i shikoja leqet e kabllot për të parë nëse i përgjigjeshin një laku të dorës apo zogut të këmbës dhe ato u përgjigjeshin. Ishte derisa po e bëja atë që pashë ato që besoj se ishin flokë njeriu. Ekipi Peja I supozoi se personat e paraburgosur aty me siguri ishin viktimat që janë gjetur në vendin e varrezës masive në Ratishën e Poshtme. Një kufomë gjithashtu është gjetur jashtë shtallës në një gropë të vogël me tel me gjemba rreth qafës; mirëpo, unë nuk kam qenë i pranishëm kur është gjetur kjo kufomë. Po e theksoj se nuk kam parë asnjë kufomë apo mbetje njerëzore në këtë pjesë të fermës.

25. Mu pranë shtallës ishte njëfarë vendi për trajnim. Ishte një pjesë e hapur, me bar dhe kishte gardh apo kufinj me gardh të blertë. Dukej se kjo pjesë ishte përdorur për qitje dhe trajnim tjetër, pasi që ende shiheshin disa shenja të qitjes. Shenjat kishin rrahë klasikë në një sfond të bardhë dhe kishin vrima plumbash. Kishte po ashtu mjete të tjera që mund të kishin qenë pjesë e një shtegu ushtarak me pëngesa për trajnim. Kur arritëm te kjo shtallë kemi ardhur nga Ratisha e Poshtme në drejtim të lindjes. Kemi arritur në vendin e kësaj shtalle pas vizitës sonë të vendi i kanalit dhe kemi shkuar në vendin e shtallës me automjet.

26. Përshtypjet e mia rreth UÇK-së gjatë kohës sime në Kosovën perëndimore ishin të trefishta. Kishte shumë shqiptarë të armatosur që kam parë gjatë kohës sime në Kosovën perëndimore. Ata mund të përshkruhen kështu. Së pari, kishte një lloj që ishin të disiplinuar dhe të pajisur mirë dhe që dukej se kishin të kaluar ushtarake. Së dyti, kishte një lloj që dukeshin se ishin individë që sapo kishin marrë një pushkë për të luftuar. Ata nuk kishin disiplinë dhe nuk ishin të organizuar. Së treti, ishte një grup të

Nënshkruar / Inicialta: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/




**Deklaratë e Achilles PAPPAS**


cilin do ta përshkruaja si eksternist; këtu i referohem vetëm atij grupi që na ka rrëmbyer. Ata vepronin ndaras brenda një rajoni të caktuar që e kishin totalisht nën kontrollin e vet. Ata kishin liderin e vet, të cilit i shkonin pas në një mënyrë bindëse, pa i vënë në pyetje personalitetin e tij apo urdhërat e tij. Duke thënë këtë i referohem personit Ramush HARADINAJ. Para se të paraqitej HARADINAJ, ushtarët e tjerë ishin vulgarë dhe silleshin në mënyrë të keqe. Sapo u paraqit ai, ata filluan të qetësoheshin dhe të silleshin në mënyrë më normale. Po e theksoj, ndërkaq, se unë e kam parë Ramush HARADINAJN vetëm dy herë duke dhënë urdhër. Urdhëri i parë është dhënë kur ai po e kontrollonte makinën dhe grupi i ushtarëve duke përfshirë femrën erdhën dhe e përshëndetën. Në atë rast ai tha diçka në shqip dhe ata menjëherë u larguan në drejtim të granatimit. Hera e dytë ishte kur i urdhëroi tre njerëzit me uniformë të zezë që na kishin rrëmbyer, duke përfshirë Idriz Balajn, që të na përcillnin.

27. Do ta përshkruaja Ramush Haradinajn si person të mençur dhe të kontrolluar. Ai dukej se ishte gjakftohtë edhe pse linja e frontit ishte shumë afër ndërtesës sonë. Gjatë marrjes sonë në pyetje, me gjithë granatimin e rëndë dhe të shtënat e pushkëve, ai mbeti i qetë dhe i balansuar. Mendoj se ishte person i mençur dhe i trajnuar mirë në terma ushtarakë. Këtë mendim e bazoj në sjelljen e tij gjatë takimit tim me të. Ai kishte kontroll total të anëtarëve të UÇK-së që ishin të pranishëm në kompleks. Urdhërat e tij përfillehin menjëherë, nuk kishte diskutim.
28. Derisa më në fund jam larguar nga rajoni i Pejës, nuk kam pasur takime të mëtejshme me asnjë prej komandantëve të UÇK-së. Jam larguar nga Ekipi Peja në fund të tetorit 1998 dhe në fillimi i nëntorit 1998, kur jam transferuar mbrapa në ECMM-në në Bosnjë.


29.



30.



31.




Nënshkruar / Inicialet: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/

**Deklaratë e Achilleas PAPPAS**


32.




33.



34.



35.



**Deklaratë**

Më është thënë se deklarata ime mund t'u ofrohet agjencive që kujdesen për rendin ligjor ose autoriteteve të drejtësisë. Unë nuk pajtohem që deklarata ime t'u jepet atyre autoriteteve në diskrecion të Zyres së Prokurores të Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale për ish-Jugosllavinë.

Nënshkruar / Inicialet: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/

**Deklaratë e Achilleas PAPPAS**

**VËRTETIM I DËSHMITARIT**

E kam lexuar këtë deklaratë dhe është e vërtetë me sa di dhe sa më kujtohet. E kam dhënë këtë Deklaratë vullnetarisht dhe jam i vetëdijshëm se mund të përdoret në procedurën gjyqësore para Tribunalit Ndërkombëtar Për Ndjekjen Penale të Individëve Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Ligjit Ndërkombëtar të Bëra në Territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991, dhe se mund të thirrem të jap dëshmi para Tribunalit.

Nënshkrimi: /nënshkrimi/

Data: 08/05/2007

Nënshkruar / Inicialet: .../nënshkrimi/.... Të tjerët të pranishëm: /dy nënshkrime/